



Gati për në çerdhe

„Të gjithë jemi të destinuar të shkëlqejmë siç bëjnë fëmijet“ (Nelson Mandela)



Gati për në çerdhe është një program/projekt i cili i'u dedikohet prindërve dhe fëmijeve të tyre të cilët akoma nuk kanë filluar të shkojnë në çerdhe, si dhe është një mbështetje për institucione arsimore dhe organizatave të ndryshme. Prindërit marrin mbështetje prej një shoqërues të angazhuar, që ju ndihmon të bashkëpunojnë më fëmijet, të cilët bazohen në mjedisin e tyre të jetesës dhe historisë, në mënyrë që të jenë në gjendje të mbështesin fëmijet e tyre.

Prindërit dhe fëmijet luajnë, këndojnë dhe pikturojnë së bashku. Përmes të këtij programi prindërit mësojnë se çfarë masash mund të ndërmarrin për të aprovuar zhvillimin e përgjithshëm dhe gjuhësor.

Qëllimet

- Përforsim në kompetencat edukativo arsimor, për prindërit që marrin pjesë
- Përforsim i marrëdhënieve mes prindit dhe fëmijes
- Mbështetje për një fillim të suksesshëm për në çerdhe
- Zgjerim i mundësive arsimore, për fëmijet që marrin pjesë
- Përforsim i shumëgjuhësisë
- Përforsim i vetëvlerësimit të prindërve dhe fëmijeve pjesëmarrës
- Përforsim i kompetencave sociale dhe ndërkulturore
- Përforsim/ Mbështetje të ndërsjellët për njëri-tjetrin në shoqërinë e përbashkët

Ofertë e programit

Gati për në çerdhe mbahet nga muaji tetor deri në qershor, një herë në javë nga dy orë mësimore (50 min. një orë mësimore). Ky program kryesisht mbahet në çerdhe, në institucione për prind – fëmijë, si dhe në institucione të emigrantëve, në Austrinë e sipërme.

Kjo punë mbështetet nga prindërit dhe prej librit (Gati për në çerdhe) e cila prindërve i'u ndihmon të gjejnë aktivitete të ndryshme për fëmijet e tyre. Këto materiale janë në shumë gjuhë dhe përmbajnë sugjerime për aktivitete të ndryshme për gjuhë – lojë.